Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## **D. DHËNIA E KONTRATËS**

### **23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
  2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
  2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më

---

vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike
- Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial .....
- Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit
- Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike .....
- Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit .....
- Shtojca 8: Termat e Referencës
- Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....
- Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....
- Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....
- Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit
- Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit
- Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- 
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

|   |  |
|---|--|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |
| <b>Datë</b> _____                         |  |

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**  
(në rast BOE): \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

| <i>1</i>                                  | <i>2</i>  | <i>3</i>     | <i>4</i>               | <i>5</i>                    |       |
|---|---|--------------|------------------------|-----------------------------|-------|
| <b>Nr.</b>                                | <b>Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike</b> | <b>Sasia</b> | <b>çmimi për njësi</b> | <b>Çmimi total (3 x 4X)</b> |       |
| 1.  |   |              |                        |                             |       |
| 2.  |   |              |                        |                             |       |
| 3.  |   |              |                        |                             |       |
| 4   |   |              |                        |                             |       |
|   | <b>Çmimi total</b>  |              |                        |                             | _____ |
| <b>Çmimi Neto pa TVSH</b>                 |   |              |                        |                             |       |
| <b>TVSH (%)</b>                           |   |              |                        |                             |       |
| <b>Çmimi total me TVSH:</b>               |   |              |                        |                             |       |
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |   |              |                        |                             |       |

---

|                   |  |
|-------------------|--|
| <b>Nëshkrimi</b>  |  |
| <b>Vula</b>       |  |
| <b>Datë</b> _____ |  |

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

## Shtojca 5.

(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

### **DEKLARATË**

#### **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_, është i pamiruar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

---

<sup>6</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

---

## Shtojca 6 .

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Objektivi i këtij projekti është ngritja e një sistemi gjeografik të qëndëruar për të dhënat hapësinore të informacionit dhe menaxhimin e aseteve, mirëmbajtjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të këtyre aseteve, shoqëruar kjo dhe me aftësinë për të mirëmbajtur dhe monitoruar komplet rrjetin e shpërndarjes së furnizimit me ujë që administron SHRUKD.

Realizimi i këtij projekti do të mbështesë aktivitetet e mëposhtme :

- Pajisja me infrastruktura softuerike GIS për menaxhimin, përditësimin dhe analizimin e rrjetit të shpërndarjes së furnizimit me ujë;

- Krijimi i një gjeodatabase qendrore e cila do të lejojë ruajtjen e informacionit gjeografik, tabelar dhe marrëdhëniet midis tyre, shoqëruar kjo me përdoruesit si dhe akseset e tyre;
- Ngritja e sistemit të qëndëruar të informacionit gjeografik të menaxhimit të shpërndarjes së ujit i cili do të përbëhet nga një sërë komponentësh klient (desktop), server, web dhe mobile;
- Standardizimin e informacionit duke përpunuar të dhënat fillestare;
- Administrimi dhe arkivimi i të dhënave të përfutuara;
- Shpërndarja e informacionit Institucioneve Përgjegjëse, Institucioneve të tjera qendrore\lokale si dhe publiku;
- Trajnimi i stafit për përdorimin e këtij sistemi

### 1.1. Qëllimi

#### Përshkrimi i detyrës

Qëllimi i këtij projekti është ngritja e infrastrukturës së nevojshme software-ike në mbështetje të SHRUKD dhe stafit përkatës. Për të arritur këtë duhet të:

- Furnizojë, instalojë dhe konfigurojë 5 programe (software) GIS desktop;
- Furnizojë, instalojë dhe konfigurojë 1 platforme GIS Enterprise;
- Ngritjen e një database hapësinore qendrore për ruajtjen e të dhënave gjeografike të aseteve të rrejtit të shpërndarjes dhe furnizimit me ujë të pijshëm;
- Vlerësojë të dhënat ekzistuese në format digjital GIS (shapefile, etj) dhe asistojë punonjësit e SHRUKD-në në konvertimin dhe ngarkimin fillestar të tyre në gjeodatabasë;
- Implementimi i shërbimeve të ndërveprimit nëpërmjet shërbimeve të web-it (web services)
- Implementimi i shërbimeve për të gjithë përdoruesit, sipas roleve të tyre;
- Trajnim i specialistëve të SHRUKD-së në përdorimin e programeve;
- Mirëmbajtje e programeve (software)

#### Hapësira gjeografike që do të mbulohet

**Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a ku përfshihen Njesit operative Durres,Rrogozhine,Kavaje,Kruje dhe Shijak.**

#### Grupet e synuara

Sektorët përkatës e Departamentit Teknik

#### Siguria e sistemit

Sistemi do të bazohet mbi modelin “Akses sipas rolit”, në të cilin çdo përdorues është i lejuar të aksesojë atë pjesë të sistemit ose të bazës së të dhënave që specifikon roli i tij.

Të gjithë të dhënat e gjeneruara nga përpunimi i informacionit gjeohapësinor do të ruhen në platformën Cloud.

Përcaktimi i nivelit të sigurisë si dhe disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit bazuar në rregulloren e administrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore.

| Disponueshmëria             | Integriteti                 | Konfidencialiteti                      | Niveli i Sigurisë          |
|-----------------------------|-----------------------------|--|----------------------------|
| <input type="checkbox"/> D0 | <input type="checkbox"/> I0 | <input type="checkbox"/> K0            |                            |
| <input type="checkbox"/> D1 | <input type="checkbox"/> I1 | <input type="checkbox"/> K1            | <input type="checkbox"/> U |
| <input type="checkbox"/> D2 | <input type="checkbox"/> I2 | <input checked="" type="checkbox"/> K2 | <input type="checkbox"/> M |

|  |  |                                       |
|--|--|---------------------------------------|
| <input checked="" type="checkbox"/> D3 | <input checked="" type="checkbox"/> I3 | <input checked="" type="checkbox"/> L |
|--|--|---------------------------------------|

Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmeria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.

Niveli i sigurisë është i mesëm (M), nëse disponueshmeria e të dhënave është D2 ose integriteti i të dhënave është I2, ose konfidencialiteti i të dhënave është K2 dhe nuk kërkohet niveli i lartë sipas paragrafit të mësipërm.

Niveli i sigurisë është i ulët (U), nëse disponueshmëria e të dhënave është D1 ose integriteti i të dhënave është I1 ose konfidencialiteti i të dhënave është K1, me përjashtim të rasteve kur niveli i sigurisë është i lartë ose i mesëm, sipas paragrafëve të mësipërm.

Rregullore të tjera të sigurisë të nxjerra nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) duhet të jenë pjesë integrale në sistem, në mënyrë që të lehtësohet dhe automatizohet sa më shumë zbatimimi i tyre.

### Detyrat specifike

Implementimi i këtij projekti do të ndahet në 5 faza:

- Faza I: Analizimi i kërkesave dhe të dhënave ekzistuese. Kjo është faza përgatitore ku SHRUKD-së dhe Operatori Ekonomik fitues do të realizojnë takime me grupet e punës, dhe do të realizohet një analizë e plotë e të gjithë detyrave funksionale, dhe procedurave të brendshme të institucionit. Gjatë kësaj faze duhet të:
  - o Identifikohen proceset e punës nëpërmjet analizimit të proceseve të brendshme të SHRUKD-së që lidhen me mbledhjen, përditësimin dhe menaxhimin e informacionit gjeografik të rrjetit të furnizimit me ujë;
  - o Identifikohen aktorët dhe akseset në sistem në përmjet analizimit të rregulloreve të brendshme të SHRUK Durrës;
  - o Identifikimin e informacionit ekzistues si dhe formatet e tyre dhe përgatitja e një plani pune paraprak për migrimin e këtij informacioni;
  - o Vlerësimin e gjendjes fizike të infrastrukturës hardware si dhe rekomandime për përmirësime të mëtejshme;
  - o Hartimi i një plani pune të detajuar për procesin e implementimit, migrimit të të dhënave, trajnimet, duke përfshirë afatet, burimet njerëzore të nevojshme dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira.
- Faza II: Ngritja e sistemit të integruar të informacionit gjeografik të menaxhimit të shpërndarjes së ujit dhe kanalizimeve. Kjo fazë përfshin lëvrimin, instalimin dhe konfigurimin e sistemit dhe të gjithë komponentët e nevojshëm software. Gjatë kësaj faze duhet të:
  - o Lëvrohen licencat e nevojshme software server dhe klient (desktop) që do të jenë pjesë e këtij sistemi;
  - o Intalohen software-t në infrastrukturën hardware të vënë në dispozicion nga SHRUKD;
  - o Konfigurohen të gjithë komponentët e nevojshëm të sistemit në mënyrë që të funksionojë si një sistem i integruar;
  - o Ngrihet gjeodatabasa hapësinore për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë;
  - o Ngritja e aplikacioneve web dhe mobile për editim, informim dhe inspektim të aseteve të rrjetit të shërbimit të furnizimit me ujë;
- Faza III: Testimi i sistemit, trajnimi i stafit dhe marrja në dorëzim e tij. Kur çdo gjë të jetë gati për përdorim do të realizohet testimi i sistemit. Gjatë kësaj faze duhet të:
  - o Trajnohet stafi në përdorimin e sistemit;

- Testohen funksionalitetet e sistemit së bashku me stafin e SHRUKD-së;
  - Dorëzimi i sistemit funksional në përputhje me kërkesat teknike të tij;
  - Dorëzimi i dokumentave/manualeve të nevojshëm për përdorim dhe administrim të sistemit.
- Faza IV: Migrimi i të dhënave fillestare. Gjatë kësaj faze do të realizohet mbledhja, përpunimi dhe integrimi i të dhënave në gjeodatabasën qendrore të sistemit të integruar të informacionit gjeografik për menaxhimin e shpërndarjes së ujit dhe duhet të:
- Mblidhet informacioni që SHRUKD disponon në formate të ndryshme, PDF, CAD, shapefile, KML/KMZ, etj.
  - Realizohet vlerësimi i saktësisë hapësinore, dhe kohore të këtij informacioni;
  - Identifikimi i përpunueshmërisë së informacionit me strukturën e gjeodatabasës;
  - Përpunimi i informacionit ekzistues dhe migrimi i këtij informacioni në gjeodatabasën e sistemit të integruar të informacionit gjeografik për menaxhimin e shpërndarjes së ujit.
- Faza V: Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes. Gjatë kësaj faze duhet të:
- Ofrohet shërbimi i mirëmbajtjes të të gjithë komponentëve përbërës të sistemit të integruar të informacionit gjeografik për menaxhimin e shpërndarjes së ujit;
  - Ofrohet mbështetje teknike kundrejt përdoruesëve në rast të problematikave teknike;
  - Ofrojnë shërbime të përditësimit të versioneve, patch-eve dhe fix-eve të ndryshëm për software-t e këtij sistemi;
  - Ofrojnë rekomandime, sygjërimë për përmirësime të sistemit të integruar të informacionit gjeografik për menaxhimin e shpërndarjes së ujit;
  - Ofrojnë asistencë stafit të SHRUKD-së në planifikimin e zgjerimeve, përmirësimeve të këtij sistemi në të ardhmen.

## Portali i WebGIS

Portali i WebGIS duhet të jetë një platformë në Web që do të shërbejë si sistem menaxhimi të përdoruesëve dhe kontentit (User & Content Management System) dhe duhet të ketë funksionalitetet e mëposhtme:

- Duhet të bëjë të mundur kërkimin, shfaqjen e të dhënave, shtresave gjeohapësinore, hartave në web si dhe web aplikacioneve;
- Duhet të bëjë të mundur vizualizimin e të dhënave në hartat web;
- Duhet të bëjë të mundur vizualizimin e të dhënave 3D në hartat web;
- Duhet të bëjë të mundur kërkimin dhe filtrimin e të dhënave në mënyrë dinamike;
- Duhet të bëjë të mundur krijimin e përdoruesëve;
- Duhet të bëjë të mundur caktimin e roleve dhe privilegjeve për përdorues të ndryshëm;
- Duhet të bëjë të mundur krijim e hartave web pa pasur nevojë për njohuri në gjuhë programimi;
- Duhet të bëjë të mundur krijimin e aplikacioneve web me bazë hartën pa pasur nevojë për njohuri në gjuhë programimi;
- Duhet të bëjë të mundur kërkimin e vendndodhjeve në bazë të adresës në hartat dhe aplikacionet që krijohe;
- Duhet te beje te mundur ndryshimin e simbologjive te shtresave te gjeoinformacionit në hartat dhe aplikacionet qe krijohen;
- Duhet të bëjë të mundur matjen e distancave dhe sipërfaqjeve në hartat dhe aplikacionet që krijohen;
- Duhet të bëjë të mundur shtimin e të dhënave nga kompjuteri apo në format e web service-ve;

- 
- Duhet të bëjë të mundur publikimin e të dhënave nga shtresa egzistuese ne Portal;
  - Duhet të bëjë të mundur konvertimin e adresave në koordinata X, Y;
  - Duhet të bëjë të mundur ruajtjen e të dhënave si shtresa gjeohapesinore ose si harta në web;
  - Duhet të bëjë të mundur shperndarjen e të dhënave, shtresave gjeohapesinore dhe hartave web, me përdoruesit brenda organizates se KESH si dhe me publikun e gjërë;
  - Duhet të bëjë të mundur të Editojë të dhënat nga Hartat Web apo Web Aplikacionet;
  - Duhet të bëjë të mundur të analizojë të dhënat;
  - Duhet të bëjë të mundur të organizojë informacionet në grupe të ndryshme;
  - Duhet të bëjë të mundur vendosjen e kushteve të ndryshme të sigurise tek të dhënat, shtresat gjeohapesinore, hartat dhe web aplikacionet;
  - Duhet të bëjë të mundur krijimin e shtresave duke shfaqur pjesë te veçanta të të dhënave nga një shtresë gjeoinformacioni;
  - Duhet te beje te mundur krijimin, editimin dhe fshirjen e perdoruesve;
  - Duhet te beje te mundur caktivizimin e llogarive te perdoruesve;
  - Duhet te beje te mundur krijimin e grupeve te ndryshme per projekte te caktuara;
  - Duhet te beje te mundur nepermjet perdoruesve administrator per caktimin e licencave te ndryshme qe duhet te ofroje Portali GIS.

## Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### Shërbimet që kërkohen që kërkohen: SIPAS TERMAVE TE REFERENCES

**Afatet e ekzekutimit:** Afati i kryerjes së shërbimit do të jetë 12 muaj duke filluar nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të planit të zbatimit të kontratës.

| Nr. | Emërtimi i fazës / Periudha kohore   | Kohëzgjatja |    |    |    |    |    |    |    |    |         |
|-----|--|-------------|----|----|----|----|----|----|----|----|---------|
|     |  | M1          | M2 | M3 | M4 | M5 | M6 | M7 | M8 | M9 | M10-M21 |
| 1   | Analizimi i kërkesave  |             |    |    |    |    |    |    |    |    |         |
| 2   | Ngritja e Sistemit të integruar të informacionit gjeografik për menaxhimin rrjetit të shpërndarjes së ujit |             |    |    |    |    |    |    |    |    |         |
| 3   | Faza e testimit, trajnimit dhe marrjes në dorëzim  |             |    |    |    |    |    |    |    |    |         |
| 4   | Migrimi i të dhënave fillestare  |             |    |    |    |    |    |    |    |    |         |
| 5   | Fillimi i procesit të mirëmbajtjes   |             |    |    |    |    |    |    |    |    |         |

---

## **Shtojca 8.**

*( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### **TERMAT E REFERENCES**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

**Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar duhet të bëjë të mundur që:**

- 1-Pasurim me raporte sipas departamenteve e listave të librit të madh analitik.
- 2-Kerkim i avancuar në dokumentat të pershkrimeve dhe në raporte.
- 3-Mundësi për upload të kopjeve të dokumentave origjinale në sistem dhe krijimi i arshivave të dokumentave origjinale në sistem në formate të ndryshme, word, excel, jpeg etj. Eksport në formate horizontal pivot të raporteve.
- 4-Link-lidhje nga raportet në dokumenta në mënyrë të menjehershme nga raporti në document.
- 5-Hapje të disa raporteve njëkohësisht dhe ruajtje e raporteve të hapura për përdorim të mëvonshëm.
- 6-Rregjistrim në disa module njëkohësisht.
- 7-Transferim i dokumentave nga arka dhe banka dhe ndërmjet të njëjtit modul në mënyrë automatike dhe raport për transferimet e vlerave monetare në modul.

- 
- 8- Oferta Cmime, krijimi i listave te cmimeve per kliente ne menyre te personalizuar dhe aktivizimi i cmimeve ne data te caktuara per periudha te caktuara , pervec 10 klasave normale te cmimeve.
- 9-Likujdime automatike nga Shitje dhe Blerja per faturat Cash dhe krijime mandate automatike.
- 10-Likujdime automatike per faturat e paspaguara me periudha kohore te klienteve ne modulet arka e banka per grup faturash ne menyre te menjehershme me referenca.
- 11-Postime automatike me departamente dhe lista sipas Artikullit, Klientit, Furnitorit etj
- 12-Pasurim me raporte te shitjes, magazinave, shtim i konceptit te furnitorit ne artikull dhe perkatesisht ne raportet perkatese.
- 13-Shtimi i njesise peshe ne artikuj dhe raportet e shitjes dhe ne dokumenta.
- 14-Menaxhim i magazinave dhe i stokut me minimum dhe maximum gjendje per magazina dhe ne kartelet-testime ne opercaione per sasite minimum dhe raporte perkatese magazine.
- 15-Menaxhim i Userave ne nivel te avancuar dhe mbajtja e ditarit te modifikimeve perkatese per identifikimin e perdoruesit dhe IP nga eshte kryer veprimi .
- 16-Mundesia manaxhimi te perdoruesve ne nivele:Klienti, Furnitori, Artikulli, LLogarie, Departamenti, Raporti, Printimi dhe eksport dokumenti, ne vijim te manaxhit te perdoruesit ne nivele ndermarrje, magazine, arke, banke.
- 17-Pasqyrimi i librave shitje-blerje ne formatin e fundit te miratuar nga tatimet, si edhe eksportin e tij direkt ne excel.
- 18- Krijim FD nga Porosia, levizje e brendshme dhe transferim automatic nga nje magazine ne.  
tjetren me njesi vartese dhe postim dhe rivlersim i permiresuar per koston mesatare.
- 19- Ndryshime te tjera stukturore te sistemit ne performance
- 20- Menaxhim dhe kontroll mbi artikujt e lene ne perdorim (artikuj te kthyeshem, ambalazh etj).
- 21- Ndjekje e procesit te prodhimit ne rang lende te pare, gjysem produkt dhe produkte si edhe rivleresim i koston mesatare ne baze te koston se percaktuar manualisht ose edhe mundesia e kalkulimit automatic te koston se produktit ne varesi te koston se perberesve, duke shkarkuar lenden e pare automatikisht ne baze te recepturave te rregjistrua .
- 22- Moduli i Aktiveve .

---

## Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

---

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

##### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

---

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024 dhe 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kësaj procedure.

**2.2.2 .** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024 dhe 2025** të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi **për shërbime** të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së së fondit të limit të përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin si dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e kesaj kontrate.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore të shitjes **dhe të deklaruara ne organet tatimore** të nënshkruara nga të dyja palët (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Operatori ekonomik duhet te demonstrojë me fakte dhe evidencat e njohuritë dhe ekspertizën që kërkohet për implementimin e këtij projekti dhe mirembajtjen:**

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, sigurisë së informacionit dhe menaxhimit të shërbimit . Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- A. ISO 9001:2015, për sistemin e menaxhimit të cilësisë, (e vlefshme ose ekuivalent dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
- B. ISO 27001:2023 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit (e vlefshme ose ekuivalent dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
- C. ISO 20000-1 për sistemin e menaxhimit të shërbimit (e vlefshme ose ekuivalent dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

---

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.*

**2.3.3** Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 3 (tre) punonjës, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për certifikime si më poshtë:

- a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për ITIL ose ekuivalente.
- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për manaxhimin e projekteve.
- c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për software-in GIS Desktop.
- d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për software-in GIS Server.
- e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për dizenjimin e sistemeve GIS.

Për të vërtetuar stafin e mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Deklaratë disponueshmërie për stafin përgjegjës;
- Certifikata përkatëse nga prodhuesit;
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës për punonjësit e mësipërm.

Personeli i mësipërm duhet të ketë aktualisht një marrëdhënie pune me ofertuesin jo më pak se 3 (tre) muaj nga data e zhvillimit të procedurës, e vërtetuar kjo me formularet 025/a .

**Një punonjës mund të jetë i certifikuar në më shumë se një nga kërkesat e mësipërme.**

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën, ne kopje origjinale ose te noterizuara, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.**

**2.3.4** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar i licencave të kërkuara për shitjen dhe suportin për territorin e Republikës së Shqipërisë. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

---

**Shtojca 10.**

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| Identifikimi   | Përgjigja      |
|--|----------------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | -----          |
| Numri NIPT/et:   | -----<br>---   |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar  | -----<br>----- |
| Përfaqësuesi (emri):   | -----          |
| Telefoni:  | -----<br>----- |
| E-mail:  | -----<br>----- |

## B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT –i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar |
|-------------------------------------|---------|-----------------------------|---|
|                                     |         |                             |   |
|                                     |         |                             |   |
|                                     |         |                             |   |

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
|------------------------|--------|--|--------------------------------------|
|                        |        |  |                                      |
|                        |        |  |                                      |
|                        |        |  |                                      |

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

| Deklarata  |
|--|
| <p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarimenëse</i> _____ <i>vlerësohet</i> _____ <i>e</i> _____ <i>nevojshme</i></p>  |
| <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime</i> _____ <i>nëse</i> _____ <i>vlerësohet</i> _____ <i>e</i> _____ <i>nevojshme</i></p>   |
